

DHIMITËR S. SHUTERIQI

FRANÇESK AVATI (1717 — 1800)

Për fillimet e folkloristikës shqiptare, nuk harrohet zakonisht të përmendet emri i një Françesk Avati¹. Me atë, me sa dimë, ka nisur mbledhja e folklorit arbëresh të Kalabrisë. Porse mbi jetën dhe veprimtarinë e këtij shkrimtari shënohen gati vetëm dy-tre fjalë: se ishte greqist i zoti, se Kamarda ka pasur në duar një përmbledhje këngësh popullore bërë prej tij, se ishte fis i nënës së De Radës dhe vdiq më 1800.

Kuptohet interesi që mund të paraqesë figura e një folkloristi të orës së parë. Duke dashur t'i njohim për së afërmi premiset e Rilindjes sonë, janë edhe në fillimet e folkloristikës shqiptare ne kemi qëmtuar, gjatë viteve, gjithçka kemi gjetur mbi Avatin² dhe po e paraqitim atë në këtë studim të veçantë, ndonëse burimet janë të pakta e të varfëra.

¹ G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo 1931, f. 249; Dh. S. Shuteriqi, *Folklori shqipe* (dispensë e Institutit Pedagogjik), Tiranë 1949, f. 26; Z. Sako, *Folklori shqiptar* (te «Historia e letërsisë shqipe» e USHT, Tiranë 1950, vëll. I, f. 8).

² Po japim, në origjinal, dëshmitë kryesore mbi jetën dhe veprimtarinë e Avatit: P. P. Rodotà, *Dell' origine, progresso e stato presente del rito greco in Italia*, Roma 1763, Lib. III, f. 77: «Sotto la sua presidenza (e Nicolò de Marchis, rektor në S. Benedetto Ullano, — Dh. S. Sh.) v'insegnò la lingua greca per nove anni il Sacerdote D. Gio. Francesco Avati, ital-greco della terra di S. Demetrio, la cui perizia delle greche discipline lo ha reso meritevole della cattedra greca ereta in Urbino dalla memoria immortale del Cardinale Annibale Albani, dove in 1750... esercitò con plauso una tal carica... Egli è guidicato abile al conseguimento di quelle dignità ed cuori, che la cieca fortuna, como spoglie rapite ai meritevoli, con mano sodiziosa vuole bene spesso attribuire ed inverstirme gl'indegni. Monsignor De Marchis fini il periodo de' suoi giorni nel giugno de 1757...» *Po aty*, shënim a, citohet: A. Zavarrone, *Historia erectionis pontificii Collegi Corsini Ullanensis*, Napoli 1750, f. 30: «Franciscus Avatus ex oppido S. Demetrii, in interpretandis praecertim Homero, Hesiòdo, aliisque auctoribus graecis excelles». G. De Rada, *Rapsodie nazionali*, Cosenza 1883-87, f. 1-2: «Kur te viti 1845 më gjeti Nanapul Dhimiter Kamarda e m'buttoi një livrith të shkruatur me ndonjë pesmbëdhiet këntka, të çuar te Koxhi arbresh Palerm, e cilat ai pak dëlgohej, edhe pse nënk'ishin te dialeti Sicilies; si i pe, njoga mbajtë gluhën e katundeve tan. Ishin të zgjedhta (zgjedhura) e gjith, thoshnje, të lera ndë Moret. «Duall e bukura ndë der», «Te gor e Anapulit», «Rrëmpes mëruame», etc. Holqa një të gjar (bëra një kopje) je përzieta me të tjerat» (këngë që kishte mbledhur). M. Marchianò, *L'Albania e l'opera di Girolamo De Rada*, Trani 1902, f. 29: «...a Napoli... connobe... Camarda... Da lui ebbe contezza di una raccolta di canti popolari albanesi fatta di Francesco Avati di Macchia, ... di cui il De Rada già conosceva un libro, ove si raccontava la leggenda della fuga della Madonna di Scutari dall'Albania in Italia, ed ove figurava una lettera dell'Avati al Rettore de' Padri Olivetani di Palermo, la quale accompagnava de' canti albanesi. Po ai, *Un autografo inedito del poeta albanese Girolamo De Rada*, Trani 1909, f. 19: «Francesco Avati, primo raccoglitore delle Rapsodie Albanesi, e che morì nella cattedra di Urbino verso 1800.» V. edhe Dh. S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1965, nr. 129.

*

* *

Francesk Avati³ ishte prej vendlindjes së De Radës, — Maki i Kozencës, pranë Sh. Mitër Koronës. Ai ka qenë nxënës i kolegjit arbëres që u krijua më 1732 në Sh. Benedikt Ulano dhe që njihet edhe si Kolegj Korsini.

Dihet roli i këtij institucioni dhe i një tjetri si ai, që u krijua dy vjetra më vonë në Palermo të Sicilisë, për fillimet e një lëvizjeje kulturele dhe letrare diçka të gjerë tek arbëreshët e përtej Adriatikut në shek. XVIII. Prej Kolegjit Korsini dolën atëhere një sërë njerëzish me emër, si greqisti demokrat Paskal Bafa, i cili dha jetën në luftën kundër autokracisë i dituri Mikel Belushi etj. Lëvizja kulturele që merr zhvillim me ta, fruitet e saj të pjekura i dha në shekullin e pasmë, me Jeronim De Radën, Anton Santorin, Vinçens Dorsën, Zef Seremben etj.

Avati duket të ketë qenë një nga nxënësit e kolegjit arbëresh të Kalabrisë, që kur ky çeli dyert. I lindur më 1717⁴, ai ishte 18 vjeç më 1735, kur nisi efektivisht punë kolegji⁵, Studimet aty zgjatnin 12 vjetra. Të paktën kaq dimë t'i ketë bërë Variboba⁶, i cili, edhe ai, ka qenë nxënës i parë të shkollës. Avati duket t'i ketë mbaruar studimet rreth vitit 1747, 30 vjeç, pra i madh në moshë, gjë që nuk duhet të na çudit për kohën. Kolegji përgatiste klerin ortodoks të arbëreshëve dhe Avati u dorëzua prift.

Më 1742, peshkop arbëresh në Kalabri dhe rektor i kolegjit u emërua një Nikolla De Markis (De Marchis), greqist. Avati vetë u bë një greqist me emër⁷ e dha mësim gjatë nëntë vjetëve dhe në kohën e De Markisit, i cili qëndroi peshkop gjer më 1757⁸. Në se mësimin e greqishtes ai filloi ta jepte në Sh. Benedikt Ulano pikërisht vitin kur mbaroi studimet, Avati ka qenë pedagog aty e pakta gjer më 1751. Atë vit në pranverë, ai është rektor i kolegjit. Po të ketë dhënë aty mësim gjatë nëntë vjetëve dhe pa ndërprerje, Avati mund ta ketë mbyllur karrierën e tij në Kolegjin Korsini më 1756.

Pjetër Pompilio Radotà, bashkëkohës i Avatit, shënon se ky, më 1750, jepte mësimin e greqishtes në Urbino, porse kjo është e pamundur me që katedra e Urbinos u krijua për kujtim të Anibal Albanit, vdekur atë vit. Avati vdiq në Urbino më 1800 si pedagog i greqishtes⁹. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi larg vendlindjes, gjë që shpjegon ndofta edhe

3) Rodotà, *po aty*, e jep kështu trajtën e plotë të emrit: Gio (vanni) Francesco Avati; G. Mazzioti, *Monografia del Collegio italo-greco di Sant'Adriano*, Roma 1908, f. 6 e jep: Gian-Francesco Avati. V. Dorsa, *Su gli Albanesi*, Napoli 1847, f. 97, e quan: Francesco Avatos.

4) Këtë të dhënë e kemi gjetur vetëm te C. Marini, *Appunti storici intorno a S. Demetrio Corone*, Catanzaro 1913, f. 8.

5) Data ekkzakte e fillimit të punës së kolegjit është: 7 mars 1735, rev. «Zjarri», S. Demetrio Corone, dhjetor 1972, f. 24).

6) P. Vasa e E. L. Mbuza, *Documenti su Giulio Variboba nell'Archivio di propaganda Fide*, Roma 1960.

7) Mësimi i greqishtes në seminarët arbëreshe dha shkas për krijimin e shumë greqistëve prej asaj origjine. Disa prej tyre kanë mbajtur katedra e kanë bërë emër në fushën e studimeve greke e bizantine, si Giuseppe Crispi, Pietro Matrangola, Nicolò Camarda etj.

8) Rodotà, *vep. cit.*, f. 78.

9) Marchiano, *Un autografo*, f. 19 thotë se vdiq «rreth 1800», kurse Dorsa, *vep. cit.*, f. 97, thoshte se vdiq më 1800.

përse nuk la kujtimin e një njeriu me veprimtari të gjerë tek arbëreshët.

Sidoqoftë, që më 1750, Avati kishte bërë emër si greqist. Bashkohësit e mbanin për njohës të zotin të Homerit, Hesiodit dhe të autorëve të tjerë të lashtësisë¹⁰. Që ta gjejmë rektor të kolegjit arbëresh të Kalabrisë më 1751, kur ai nuk është më shumë se 34 vjeç, kjo tani kuptohet. Datën e zgjedhjes së tij nuk e dimë, po duket të ketë qenë ai vit shkollor.

Zgjedhja e Avatit në krye të kolegjit nuk i erdhi për hosh de Markisit, i cili reagoi me të madhe: duke mos pyetur komunitetin, që kishte të drejtën e zgjedhjes së rektorit, ai e pushoi Avatin dhe, në vendin e tij, emëroi Jul Varibobën¹¹. Për këtë nuk dimë të kishte bërë akoma emër si poet, po ka të ngjarë që të jepte edhe ai mësim në kolegji. Variboba ishte edhe më i ri se Avati, 27 vjeç. Më 17 prill 1751, Avati protestoi te mbreti i Napolit; më 15 maj të atij viti, De Markisi e informon Vatikanin se ai qe «i detyruar të pranonte dorëheqjen» e Varibobës, për shkak të këmbënguljes së komunitetit arbëresh, por edhe të ndërhyrjes së kurisë së Rosanos, nga varej kisha e tij. Disfata e De Markisit dhe e të përkrahurit të tij qe e rëndë. Ka të ngjarë që Avati të ketë ruajtur vendin si rektor deri më 1756, po për këtë s'kemi asnjë të dhënë.

S'ka dyshim që gjesti prezumptuoz i De Markisit, nuk qe një çështje mërie personale. Mosmarrëveshjet ndërmjet tij e Varibobës, nga njëra anë, dhe Avatit, nga tjetra, duket të kenë qenë të thella e më të vjetra, që plasën me këtë rast. Që kundërshtarët e tij dështuan, kjo tregon se mbështetja që gëzonte Avati ndër arbëreshë qe shumë e fortë, për arsye të rëndësishme, të cilat vunë në lëvizje popullin.

Në të vërtetë, skandali, si mund të quhet, i vitit 1751, ishte preludi i një skandali edhe më të madh, për të cilin u bë shkak edhe një herë Variboba më 1760 e që i kishte rrënjët thellë e larg.

Më 1751, pasi u dëbua nga rektorati, Variboba u kthye në shtëpi, në katundin Mbusat, dhe atje, si prift që i zuri vendin t'et të moshuar, ia nisi veprimtari që të përgatiste kthimin në ritin latin të bashkëfshatarëve të vet. Nga e merrte atë guxim poeti, në mos, në radhë të parë, nga De Markisi, që ishte i një mendjeje me të? Po më 1760, lëvizja popullore arbëreshe kundër Varibobës u bë kaq e fortë, sa Vatikani e largoi atë nga vendlindja. Më 1761, Variboba vendoset në Romë, kthehet katolik dhe jeton akoma 27 vjet si sekretar i një urdhëri fetar. Më 1762, ai siguron mjetet për botimin e vjershave që ka shkruar për t'i shërbyer apotazisë, gjë që tregon se nuk ka hequr dorë nga lufta¹².

Në një pjesë jo të vogël, arbëreshët ishin fshatarë gjysmë të lirë. Feudalët e Mbretërisë së të Dy Sicilive synonin nënshtrimin e tyre të plotë dhe kisha katolike, feudali më i madh i kohës, ishte e para e inte-

10) Zavarrone, *vep. cit.*, f. 30.

1) Vasa, Mbuzati, *vep. cit.*, sipas dokumentit të Arkivit të Propaganda Fides, Scrittura riferite in Congressi Italo-greci dal 1741 al 1760, Vol. IV, fol. 236.

2) Mbi veprimin apostazik të Varibobës, vështro edhe veprën e Mikel Belushit: *Alla relazione di monsignor Cardamone, arcivescovo di Rossano, al Delegato della Real Giurisdizione contra l'Arciprete albanese di S. Giorgio, risposta di Filatelo*, pa vend botimi, datuar më 8 nëntor 1794; V. Selvaggio, *Una lettera inedita contro l'Arciprete Masci*, Roma 1965. Për Varibobën rektor në Sh. Benedikt Ulano, ka folur G. De Rada, *Antologia albanese*, Napoli, 1896, f. 59, shënim 1.

resuar. Këmbimi i ritit bënte që arbëreshët t'i nënshtroheshin plotësisht kishës feudale, me të cilën bashkoheshin klerikë të ndryshëm dhe njerëz nga paria arbëreshe, sepse siguronin poste e privilegje. Presioni i propagandës katolike shoqërohej nga dhuna e përdhuna, nga nxitja edhe e popullsisë italiane kundër arbëreshëve, gjë që shkaktonte grindje e zemëra të vazhdueshme. Këmbimi i ritit kishte si pasojë jo vetëm nënshttrimin e plotë ekonomik, po, herët a vonë, ai impononte që arbëreshët t'i braktisnin traditat e tyre të lashta. Kjo sillte me vete asimilimin, të cilin arbëreshët e kanë luftuar me çdo mjet gjatë shekujve. Ishte pra një çështje jete ose vdekjeje për ta. Kemi treguar gjetiu se si lufta e egër që u bë arbëreshëve në planin fetar, pati pasojë negative edhe për kulturën e tyre: kështu humbën shkrimet fetare shqipe, që ata kishin sjellë me vete nga atdheu i të parëve¹³. Po qëndresa e tyre, pavarësisht se qe shumë e vështirë dhe pati humbje e sakrifica të mëdha, triumfoi.

Më 1732-34 arbëreshët e Jugut italian mundën të çelnin dy kolegje. Ato filluan të krijonin tani një numër më të mirë kuadrosh me shkollë dhe jo vetëm për nevojat e kishës. Nisi menjëherë edhe përpjekja e tyre për një zhvillim më të shpejtë të kulturës në gjuhën amtare, si dhe për ruajtjen e traditave kulturore e sidomos letrare popullore, që s'i kishin humbur, përpjekje e cila kishte nisur të gjallërohej që në fund të shekullit XVII, kur atyre iu desh ta rritnin qëndresën. Gjithë këto i jepnin dorë forcimit të ndërgjegjes së kombësisë dhe ruajtjes së autonomisë shpirtërore. Në krye të qëndresës arbëreshe u vunë tani disa të shkolluar si Avati e Belushi në Kalabri, si Parrino e Keta në Sicili.

*
* *

Letërsia arbëreshe e shek. XVIII i ka gjurmat e ndeshjes për të cilën folëm, veprat e Varibobës, p.sh., i cili e ka shprehur haptazi edhe përbuzjen e vet për gjuhën amtare¹⁴. Poeti krijoi jo vetëm nën ndikimin e madh të letërsisë fetare italiane të kohës, por edhe duke e mbytur gjuhën me italianizma. Po ndonëse kultura italiane ushtroi veprimin e saj mbi përpjekjen e re arbëreshe për zhvillimin e kulturës së tyre në shek. XVIII, veprim që do shpjeguar veçanërisht me faktin se kultura arbëreshe u zhvillua në ambientin italian dhe nën hegjemoninë e pashmangshme të kulturës më të zhvilluar të vendit, qëndresa arbëreshe kundër asimilimit u tregua, sikundër thamë, e pathyeshme. Në fushën e kulturës, kjo u duk sidomos në folklor.

Folklori, bartës të të cilit janë masat popullore, i ruajti mirë tek arbëreshët krijimet e tij të lashta dhe mjetet tradicionale të shprehjes. Ndryshimet që imponoi koha dhe vendi, nuk qenë të mëdha, me një ndikim të kufizuar italian në shumicën e rasteve dhe të ngulimeve. Ky ndikim qe më i dukshëm mbi gjuhën e sidomos në fjalor. Prapë gjuha u ruajt në përgjithësi mirë dhe e luajti fort rolin e saj për dallimin e kombësisë së arbëreshëve dhe për unitetin etnologjik të ngulimeve të tyre të shumta.

Në gjuhën, zakonet e doket e tyre, arbëreshët e ditur u përpoqën të gjejnë mbështetjen e madhe kundër asimilimit dhe për zhvillimin e kulturës amtare, që i shërbente qëndresës së tyre dhe e forconte. Kolegjet

13) *Gjurmime letrare*, Tiranë 1974, f. 14.

14) Në dedikimin që i bën veprës.

arbëreshe të Kalabrisë dhe Sicilisë kishin si gjuhë mësimi italishten. Aty mësohej edhe latinishtja e sidomos greqishtja, gjuhë e ritit bizantin. Porse aty lindi një përpjekje serioze për lërimin e shqipes dhe për krijimin e një letërsie shqipe, kryesisht fetare dhe didaskalike, — poezi, katekizma, prova gramatikore dhe fjalori etj. Lindi, në të njëjtën kohë, një përpjekje serioze për zbulimin e lashtësisë së popullit shqiptar e të gjuhës së tij, për njohjen e historisë së Shqipërisë dhe të ngulimeve arbëreshe, përpjekje që pati autorë të zot, si Radotà, Parrino e sidomos Keta. Gjithë këto patën, në përgjithësi, një karakter pozitiv, sepse gjuha lërohej dhe kombësia afirmohej e fitonte një ndërgjegje më të madhe të vetvetes.

Në këtë atmosferë nisi të mblidhet edhe folklori arbëresh. E para përmbledhje e tij e njohur është ajo e Nikolla Filjes, «Këngët e pleqërisë» (1737). Në Evropë s'ka marrë ende zjarr lëvizja për njohjen e mbledhjen e traditave popullore, që do të shpërthejë pas botimit të «Këngëve të Osjanit» (1760). Interesi që lindi tek arbëreshët për mbledhjen e këngëve të vjetra popullore, ka të bëjë me impulsin e brendshëm të përpjekjes që ata e ndjenin jetësore për të ruajtur traditat e tyre. Ndjenjat patriotike i shohim të shprehen haptazi në një prej këngëve të mbledhura nga Filja, ku bëhet lutje për «Arbërin fatmirë»¹⁵.

Në Kalabri, gjatë shek. XVIII, kemi vetëm Avatin që dimë të jetë marrë me mbledhjen e këngëve tradicionale shqipe. Avati, i cili më 1751 ishte rektor i Kolegjit Korsini dhe në luftë me De Markisin e Varibobën, ka qenë, pa dyshim, një nga eksponentët e qëndresës arbëreshe të kohës.

Ndjenjat fetare, edhe tek ai, si te Filja, mplekseshin me ndjenjat patriotike. Ai shkroi një broshurë mbi të ashtuquajturën «mrekulli» të një ikone, për të cilën besohej, se, «fluturim», u nis nga Shkodra e pushtuar me luftë nga turqit dhe ra në Itali. Broshurën ua dërgoi klerikëve arbëreshë të Sicilisë. Ajo s'dimë a ruhet kundi, po De Rada e ka njohur, bashkë me një letër që e përcillte. Gjejmë kështu një kontakt të arbëreshëve të ditur të Kalabrisë me ata të Sicilisë, në një kohë kur marrëdhëniet midis të dy palëve nuk qenë të shpeshta¹⁶. Ai kontakt u bë përmes një simboli, me këtë rast, fetar, të qëndresës së madhe të të parëve të tyre kundër turqve në kohën e Skënderbeut, dhe u bë në një çast të forcimit të qëndresës së përbashkët të arbëreshëve kundër feudalizmit italian. Që e natyrshme që kjo qëndresë të kuptohej së pari në planin fetar. Në kohën e feudalizmit, ideologji sunduese ishte feja. Porse, sikundër e shënuam, në shek. XVIII, qëndresës arbëreshe nuk i mungonte edhe një element i fortë i vetëdijës së kombësisë. Arbëreshët e njihnin veten krejt të dalluar nga italianët, ishin krenarë për këtë dhe ishin, me të drejtë, të egërsuar kundër italianizimit.

15) M. Marchianò, *Canti popolari albanesi delle colonie d'Italia*, Foggia 1908, f. 16.

16) Po dimi, p.sh., për këtë kohë, se Pompilio Rodota ishte në letërkëmbim për çështjet e historisë së kolonive arbëreshe, si dhe të kombësive së shqiptarëve, me rektorin e kolegjit të Palermos, Paolo Maria Parrino (M. Sciambra, *Di alcune lettere inedite di Girolamo De Dada a Demetrio Camarda*, Roma 1966, f. 4). Fakti është me rëndësi të veçantë.

Fakt me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Avatit e për ndjenjën që e frymëzonin, është se ai nuk u dërgoi bashkëkombësve të Sicilisë vetëm broshurën e tij me përmbajtje mistike, po, në të njëjtën kohë, edhe një përmbledhje këngësh popullore arbëreshe të Kalabrisë, që e kishte bërë vetë. Ky ishte më se një simbol i qëndresës së tyre të përbashkët të «Dheu lëti», — Italia. Ishte një grimë e gjuhës dhe e kulturës së tyre të përbashkët, e thesarit që ata ruanin nga pleqtë e për të cilin përgjyroheshin.

Mund të bëhet pyetja, se mos Avati ka pasur marrëdhënie edhe më parashme me arbëreshët e Sicilisë dhe se mos këta, që dimë t'ia kenë hyrë që herët mbledhjes së «këngëve të pleqërisë», e nxitën të diturin e Kalabrisë, që t'i mblidhte e t'ua dërgonte t'i njihnin edhe ata këngët e vëllezërve të tyre të asaj ane, ku gjendeshin edhe pjesa më e madhe e ngulimeve arbëreshe, siç gjenden edhe sot. Për këtë s'kemi asnjë të dhënë. Nuk dimë, për fat të keq, brendinë e përmbajtjes së letrës, me të cilën Avati kishte përcjellë broshurën dhe koleksionin e tij të këngëve në Sicili. Që këtë lëndë ai ua dërgon bashkëkombësve arbëreshë nëpërmjet një urdhëri katolik në Palermo, kjo ndofta tregon, se ai tani së pari provon të lidhet me ta, përmes të tjerësh, të cilët i kishte të njohur. Duhet besuar se këngët tradicionale arbëreshe të Kalabrisë, Avati i mblodhi me inisiativën e vet, në mos kjo punë ka nisur me kohë atje, si dhe në Sicili.

Sidoqoftë, e rëndësishme është që folklori arbëresh mblidhej në Sicili e në Kalabri afërsisht në të njëjtën kohë. De Rada na mëson se Avati i mblodhi këngët popullore përpara se të botonte vjershat Variboba¹⁷, d.m.th. përpara vitit 1762, një çerek shekulli pas Filjes. Kjo ka ngjarë pra në vitet e ndeshjes së Avatit me De Markisin e Varibobën, në kohën kur arbëreshët e Kalabrisë e kanë afirmuar dy herë me forcë qëndresën e tyre. Mbledhja e këngëve tradicionale prej tij është e lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë e Avatit në krye të asaj qëndrese, me ndjenjat patriotike që atë e kanë frymëzuar.

Për fat të keq, këngët që ai mblodhi ne i njohim pak, sepse pak gjë u botua prej tyre, kurse dorëshkrimi nuk dimë ç'u bë. De Rada na mëson se ato ishin 15. Midis tyre ai përmend tri këngë legjendare: «Dual e bukura në derë», «Te gorë e Anapulit» dhe «Rrëmpep mërueame». Këto i ka botuar edhe ai vetë të «Rapsoditë», ndofta edhe duke u bazuar te variantet e Avatit.

Në mbarim të vitit 1845, kur erdhi e u vendos në Napoli, Kamarda i tregoi poetit një përmbledhje të vjetër këngësh popullore arbëreshe, të cilat ai nuk i kuptonte sa duhet dhe që De Rada jo vetëm i njohu menjëherë se qenë të folklorit arbëresh të Kalabrisë, por edhe ai atribuoi dorëshkrimin Françesk Avatit. Vetë Kamarda, në «Shtojcën» e «Gramatikës» së tij, më 1866, të njëjtin vit që dolën edhe «Rapsoditë» e De Radës, botoi edhe 8 këngë popullore arbëreshe të Kalabrisë, midis të cilave 4 ishin nxjerrë nga përmbledhja e Avatit (nr. 1-2 dhe 5-6)¹⁸. Ndër to ishin 3 këngë

17) G. De Rada, *Principi di estetica*, Napoli 1861, f. 61.

18) Dy prej atyre këngëve, Kamardës ia kishte dërguar Giuseppe Angelo Nociti (nr. 3-4), mik i De Radës, prej Specanës së Kozencës, dhe dy, miku tjetër i De Radës Vincenzo Dorsa, prej Frashnitës (nr. 7-8). Kënga nr. 8, «Rinia e Rodhovani», si është vërtetuar më vonë, nuk ishte popullore, porse një krijim i De Radës (G

legjendare, «Kostantini i vogël», «Kostantini e Garentina» dhe «Martesa plakut», kurse e katra ishte, në fakt, një përmbledhje e «Këngëve të Dasmës», ku, nën të njëjtin numër, rreshtoheshin 16 këngë të shkurtra.

Nga përmbledhja e Avatit pra njohim drejtpërsëdrejti vetëm 3 këngët legjendare dhe «Këngët e dasmës», që na dha Kamarda; dimë se ajo ishte edhe tri këngë të tjera legjendare, titujt e të cilave na i ka dhënë De Rada; — pra 7 këngë mbi 15. Te De Rada nuk mund të mbështetemi për të njohur 3 këngët për të cilat ai na flet. Po mund të mbështetemi te notimi i Kamardës për të dhënë një ide më konkrete të punës së Avatit mbi folklorin. Prapë, edhe Kamarda, nuk na i ka dhënë këngët ashtu si i gjeti: ai u ka prekur vende-vende gjuhën, ndonëse, disaherë, na jep në paranzë edhe trajtën e origjinalit.

Le të shënojmë se Kamarda nuk na thotë asgjë për alfabetin që përdorte Avati. Ne kemi hedhur hipotezën se alfabeti që përdor De Rada më 1833, mund të jetë ai i Avatit¹⁹. Kamarda nuk na dha një informatë, e cila do të kishte qenë e çmueshme për të caktuar edhe më mirë lidhjet e punës së De Radës për shqipen me punën e paraardhësve të tij të shek. XVIII në Kalabri, ose do ta hidhte poshtë hipotezën e sipërme.

*

* * *

Këngët që na kanë arritur nga dorëshkrimi i Avatit, përmes botimit të Kamardës nuk kanë më shumë se 306 vargje. Është një lëndë e paktë për të dhënë një ide të mjaftueshme mbi punën e folklorit e pak mbi gjendjen poezisë popullore arbëreshe të Kalabrisë në mesin e shek. XVIII. Prapë duhet të kënaqemi me kaq dhe të përpiqemi të nxjerrim nga kjo lëndë nga të dhënat që kemi prej De Radës disa konkluzione.

Së pari, le të vemë re se këngët që dimë të ketë mbledhur Avati, si dhe legjendaret, si ato të dasmës, i pikasin folklorit tradicional arbëresh. De Rada mendonte se këngët e përmbledhjes së Avatit, thuajse të gjitha, përkitnin folklorit arbëresh të ardhur në Itali nga Moreja. Është fjala për letërsinë gojore që kanë sjellë në Itali, në vitet 1532-33, ata arbëreshë që lanë brigjet e Mesenisë, që u pushtuan nga turqit. Këtë çështje do ta njohim më tej. Sidoqoftë, pohimi i De Radës na detyron të konkludojmë se Avati kishte mbledhur vetëm ose gati vetëm këngë nga folklori tradicional arbëresh. Ai nuk mblodhi, me sa duket, këngë me ndikim të madh italian. Të tilla mund të kishin qenë, fjala vjen, xgarçetat, kuplete lirike

¹⁹ Haxhihasani, *Rreth dorëshkrimit të Mikel Belushit dhe disa çështje të folklorit arbëresh*, në «Studime filologjike», Tiranë 1966, nr. 1; F. Solano, *Bellusci o De Rada?*, Roma 1966; v. dhe *Gjurmime letrare*, f. 35-87. De Rada na mëson se kënga nr. 7, e botuar prej Kamardës, i kaloi këtij prej Dorsës, bashkë me të tjera dorëshkrime që këtij të fundit ia kishte dërguar De Rada, pasi këngët i kishte përthyer italisht Engjëll Bazile (*Sciambra*, vep. cit., f. 23, letër e 10 korrikut 1866). Është e qartë se kemi të bëjmë me mbledhjen e parë të këngëve popullore arbëreshe të Kalabrisë, që bëri më 1833 De Rada, dorëshkrimi i së cilës iu atribua gabimisht një Mikel Belushi të shek. XVII, bashkë me nr. 7, Dorsa kuptohet se i dërgoi Kamardës edhe këngën nr. 8. Përpara se të sqarohej çështja e dorëshkrimit të pseudo-Belushit, kënga nr. 8 që botoi Kamarda, nuk dyshohej se ishte një krijim i De Radës. As poeti vetë nuk ia zbuloi këtë Kamardës më 1866.

²⁰ *Gjurmime letrare*, f. 41-42.

të rimuara, — këngët tradicionale arbëreshe e përdorin fare pak rimë — lirike, por edhe satirike, që më vonë dimë se u bënë një gjini e re dhe shumë pjellore e folklorit arbëresh të Kalabrisë. Mos xgarçetat e nisë atje jetën më vonë se shek. XVIII? Nuk mund ta themi. De Rada vetë nuk botoi veçse ndonjë prej tyre. Ato nuk i gjejmë as në dorëshkrimin e tij të vitit 1833 dhe as në një dorëshkrim të madh të Dorsës. Pra, folkloristët arbëreshë, siç është e kuptueshme, u interesuan thuajse vetëm për folklorin e tyre tradicional.

Një këngë si ajo e «Kostantinit të vogël» ka qenë ndër më të përhapurat e folklorit arbëresh, — e po kështu edhe të folklorit të Shqipërisë — e lidhur ngushtë gjithashtu me dasmat, në të cilat këndohej pikërisht sepse flet për besnikërinë bashkëshortore. Një tjetër këngë, si ajo e «Kostantinit e Garentinës», ka qenë gjithashtu ndër më të përhapurat dhe, nga ana tjetër, ka në themel idenë e besnikërisë së madhe, — këtu edhe përte varrit, — ndaj fjalës së dhënë. Arbëreshët ishin krenarë të zakonit të besës, që hyn ndër vetitë e larta të popullit tonë. Këngët e dasmës flitnin për zakonet e bukura që arbëreshët kishin marrë me vete në dhe të huaj dhe që i ruanin me xheloz. Nuk është fjala dhe kaq për zakonet kristiane, që pak gjurmë kanë lënë mbi këngët tona të dasmës në përgjithësi, se sa për rite prej origjine pagane, të cilat e kanë humbur me kohë edhe kuptimin fetar, po që flasin për nevojën e një familjeje të fortë, sigurisht patriarkale. Ato zakone i përgjigjeshin botëkuptimit fetar e konservator që sundonte në fshatarësinë arbëreshe, po në të njëjtën kohë, edhe qëndresës së tyre, që kishte edhe një karakter konservator të natyrshëm, siç e kanë shpesh popullsitë minoritare e të shpërngulura. Kënga e «Martesës së plakut» lidhej edhe ajo me zakonet dhe veçanërisht me idenë thellësisht popullore që i dënon martesat jashtë moshave. Ajo sillte edhe elementin e vet satirik midis këngëve të tjera, që ishin lirike, edhe ato legjendaret, të tipit baladë. Të tipit baladë dhe lirike janë edhe ato tri këngë të dorëshkrimit të Avatit, për të cilat De Rada na jep vetëm titullin, por që i njohim prej varianteve që ai ka botuar te «Rapsoditë» (Lib. III, nr. 20, 21, 23). Në to gjejmë edhe theksat epike të luftrave të stërgjyshërve tanë me turqit.

Avati mblodhi këngët tradicionale, ato këngë që, me të drejtë, arbëreshët mendonin se i kishin sjellë me vete në Itali. Në to pasqyroheshin disa prej vetijave më të çmuara të popullit të vet dhe përmes tyre vinte jehona e luftrave heroike të të parëve. Ai mblodhi këngë rituale, epiko-lirike, satirike. Kishte se ç'farë t'u tregonte Avati bashkëkombësve të tij të Sicilisë, me këtë pjesë të thesarit të vet popullor. Nga larmia e lëndës dhe nga vlerat që ajo lëndë paraqiste, përmbledhja e Avatit të kujton plotësisht përmbledhjen që na ka lënë Filja. Të dy palët mblodhën relativisht pak këngë, — Filja 18 e Avati 15, — po këto ishin mjaft për të dhënë një ide të vlerave më kryesore të poezisë popullore arbëreshe të Sicilisë e të Kalabrisë në shek. XVIII.

De Rada mendonte se këngët e mbledhura nga Avati i përkitnin folklorit të arbëreshëve të ardhur në Itali prej Moreje. Për ato këngë, të cilave ai u jep titullin, kjo është e vërtetë. Në variantet që jep ai vetë prej këtyre këngëve, i hasim gjurmat e prejardhjes së tyre në emrat e Anapulli

(Nauplia), të Koronit e të Modonit, qytete bregdetare të gadishullit të Peloponezitet, të populluara prej shqiptarësh e pakta që nga shek. XIV, kur ngjante shpërngulje të mëdha shqiptare drejt Greqisë. Arbëreshët mendonin, — kështu, ndër të tjerë, Kamarda, — se këngët që disa nga të parët e tyre i sollën në Itali nga Moreja, kishin vajtur dikur në More prej Shqipërie (në shek. XIV). Teza është me rëndësi të madhe për historinë e folklorit tonë dhe veçanërisht të këngëve legjendare. Po le të vemë re se duket që De Rada i quante të ardhura nga Moreja edhe këngët e dasmës dhe këngët legjendare që botoi Kamarda prej dorëshkrimit të Avatit. Në të vërtetë, në këtë pjesë të këngëve, s'ka ndonjë element që t'i lidhi ato me Morenë. Ato fare mirë mund të kenë vajtur në Itali drejtpërdrejt nga Shqipëria, pra në shek. XV, duke qenë sigurisht, më të vjetra. Sidoqoftë, edhe folkloristë si Avati, Filja etj. mund ta çmonin vjetërsinë e këngëve që mblodhën, prandaj ndofta edhe u kufizuan të mblidhnin vetëm këngët tradicionale. Po ne nuk dimë se si e trajtonin çështjen.

Avati kishte mbledhur disa këngë që janë ndër më të përhapurat tek arbëreshët e Kalabrisë. Dhe jo vetëm kaq. Këngët e «Konstantinit të vogël» dhe të «Konstantinit e Garentinës», si dhe ndonjë tjetër, ishin të përhapura edhe në folklorin arbëresh të Sicilisë. Kështu Avati u dërgonte bashkëkombësve të tij të Sicilisë këngë që flitnin për një trashëgim kulturor të përbashkët. Ai mund të mendonte që këngët e dasmës së të dy palëve, të bazuara në zakone dhe rite të njëjta ose të afërta, ishin të afërta e të ngjajshme midis tyre, dhe, po të mendonte kështu nuk gaboj. Është po ajo ndjenjë patriotike që e kishte frymëzuar folkloristin për t'iu vënë mbledhjes së thesarit popullor, mbase e shprehur tani me idenë e kompaktësisë së popullit të vet të shpërndarë, e unitetit të këtij populli përtej krahinave dhe deteve. Ishte një ide e madhe, që duket se i frymëzoi folkloristët tanë që në fillim e që e përshkoi folkloristikën tonë gjatë tërë kohës.

Këngët që botoi Kamarda prej dorëshkrimit të Avatit më 1866, gjenden edhe te «Rapsoditë» e De Radës, të botuara po atë vit. Pra, një krahasim imponohet, qoftë për të parë evolucionin e tyre brenda një shekulli, qoftë për të verifikuar se mos De Rada, i cili e njohu dorëshkrimin e Avatit, ato këngë i ka marrë drejtpërdrejt prej tij dhe i ka botuar paralelisht me Kamardën, duke i çmuar variantet e Avatit për vjetërsinë e tyre, në krahasim me variante të tjera që ai ka pasur në dorë.

Një krahasim i thjeshtë na provon se, gati varg për varg, kënga e «Kostandinit të vogël», që gjendet te «Rapsoditë» e De Radës (Lib. II, nr. 16), është identike me atë të Avatit, që botoi Kamarda. Poeti i ka «përmirësuar» aty-këtu gjuhën, i ka bërë edhe ndonjë stilizim të lehtë, duke i këmbyer vendin edhe ndonjë vargu, për ta bërë tekstin më të kuptueshëm, ndonëse ai nuk paraqit vështirësi kuptimi, sidomos për arbëreshët, për ta vënë, sigurisht, edhe në «tonin» e përgjithshëm gjuhësor të rapsodive të mblidhura në kohën e tij dhe të prekura, cila më pak e cila më shumë, prej tij. Këto janë tipike të punës së De Radës me folklorin, punë që, për këngë të tjera, ka teprime. Te Avati, kënga kishte 125 vargje, te De Rada ajo ka 124.

Kënga e dytë që na ka dhënë Kamarda prej dorëshkrimit të Avatit, «Kostantini e Garentina», nuk është e plotë, po e përgjysmuar. I mungon gjithë ajo pjesë e fillimit, gjersa Kostantini vete e gjen të motrën në

dhe të huaj, tek e ka martuar. Sigurisht, De Rada nuk mund të kënaqet me riprodhimin e këtij varianti. Ai duhet të ketë pasur edhe variante të tjera, ndonjë prej të cilave i afrohej më shumë asaj të Avatit për nga mënyra e tregimit. Poeti mori gjithë fillimin e një varianti që kishte, vazhdoi me pjesën më të madhe të variantit të Avatit (vargjet 1-40), duke sjellë ndryshime si ato që treguam për këngën e «Kostantinit të vogël», por duke sjellë më tej ndryshime aq të mëdha, sa mund të thuhet se fundi i variantit që ai botoi, nuk ka të bëjë me tekstin e Avatit, po më shumë me ndonjë tekst tjetër që ai kishte. Nga 60 vargje gjithsej, kënga nuk mund të mos dublohej, po të ruante, sikundër e ruajti, ritmin e tregimit që kishte në variantet e Avatit: ajo arriti në 132 vargje (Lib. I, nr 17).

Ky rast është tipik i «rindërtimeve» që bënte De Rada dhe që ia lejonin vetes folkloristët romantikë. Duke i gjetur shpesh të cunguara këngët sepse nuk mbaheshin mend gjithkund mirë, sepse kishin nisur ta pësojnë e të humbasin, — më 1847, Dorsa dëshmon se në vendlindjen e tij, Frashëritë, këngët ruheshin vetëm fragmentarisht, pra ai ndjente edhe nevojën e «rindërtimit» të tyre²⁰, — De Rada me shokë iu vunë punës së «rindërtimit» të këngëve, duke përdorur variantet e fragmentet e mbledhura në fshatra dhe nga njerëz të ndryshëm. Veçse këtë, ata duket se e bënë edhe për ndonjë këngë që ruhej ende mirë në kujtesën e popullit, siç ka qenë kënga e «Kostantinit e Garentinës», për të arritur në një variant që të paraqiste trajtën më «autentike», ose më të plotë e më të bukur, që mendohej se duhej të kishte pasur kënga. Në rastin tonë, fragmenti që mori prej Avatit, De Radës i ka shërbyer si mbështetje për të na dhënë një variant të tillë. Ai fragment kishte preferencën, sepse kishte qenë mbledhur përpara një shekulli, pra mund të vështrohej si më autentik me të drejtë.

Mund të bëhet pyetja përse Avati nuk e mblodhi të plotë këtë këngë. Por ai sapo kishte zënë të mblidhte folklor, kurse për këtë punë duhen bërë edhe kërkime të veçanta.

Për sa i takon këngës së «Martesës së plakut», varianti e Avatit, që na ka dhënë Kamarda, paraqit ndryshime të tilla me variantin e botuar nga De Rada, sa të mendosh që poeti e ka rimbledhur këngën. Te De Rada, kënga është më e gjatë (52 vargje, — 10 më shumë); ajo është më e plotë nga fundi. Ndërsa varianti i Avatit ruan kujtimin e Venetisë²¹, për ku janë nisur nëntë trima e nëntë vasha arbëreshe, ndërsa aty kemi një «shatore» dashnorësh, pra kemi ndofta kujtimin e jetës baritore e shteg-tuese që bënë shpesh arbëreshët para dhe pasi kapërcyen në Itali, këto elemente nuk gjenden në varianten e De Radës. Që kjo këngë nuk dimë të jetë mbledhur tjetër herë nga folkloristët arbëreshë, — ajo nuk gjendet në dorëshkrimin e De Radës të vitit 1833 dhe as në një përmbledhje dorëshkrim të Dorsës, që kemi njohur, — mund të mendohet se ka qenë e rrallë që në kohën e Avatit.

Këngët e dasmës të mbledhura nga Avati ishin 16: kaq botoi Kamarda. De Rada botoi 21 këngë të tilla më 1866 (Lib. II, nr. 14), kurse më 1833, do-

20) Po aty, f. 133.

21) Venetia përmendet edhe në një këngë të dorëshkrimit të Dorsës, ku Anibeku është nisur t'i rrëmbejë të kumatën Miloshinit, i cili gjendet (banon?) në Veneti (f. 9-10 e dsh., kënga nr. XIV, «La morte di Anibeco»).

shkrimi i tij nuk mbante më shumë se 11. Botimi i De Radës takon në këngë me mbledhjen e Avatit, këngë që janë gati identike te njëri e tjetri. Përmbledhja e Avatit me atë të De Radës së vitit 1833 nuk ka afrime të vërteta, por edhe kjo e këtij viti, me botimin e vitit 1866 të De Radës. Mbledhja e vitit 1833 pra nuk është pasuruar me atë të Avatit, për të arritur të De Rada botimin e vitit 1866. Ka mundësi që, për këtë botim, poeti ta ketë shfrytëzuar përmbledhjen e Avatit, në ato këngë që janë identike me mënjimet tyre.

Konstatimet e mësipërme janë të rëndësishme për të njohur punën e De Radës me folklorin, po veçanërisht për të zbuluar edhe më konkretisht shprehjet që ka pasur puna e tij me atë të paraardhësit të shek. XVIII. Këto shprehje sigurisht ekzistojnë edhe në të tria këngët që poeti përmend prej Avatit dhe që nuk i ka botuar Kamarda. Po është e pamundur të bëhet ndryshimi, sa kohë nuk kemi variantet e Avatit. Kaq mund të thuhet, se variantet e Avatit, si dhe ato të De Radës, kishin elemente që tregonin lidhjen e përkritnin folklorit të arbëreshëve të ardhur në Itali nga Moreja.

Prej krahasimeve që bëjnë, na dukej e pamundur, që të dalloheshin ato këngë se cilat kanë qenë ndryshimet që solli prej vetiu koha, përmes evolucionit të këngëve në gojën e popullit, dhe cilat kanë qenë ndryshimet që De Rada u imponoi këngëve, që ai mori nga dorëshkrimi i Avatit. Ne nuk mund të themë sa duhet kësaj pune, e cila do të bëjë një ditë.

Kemi mendimin se gjuha e teksteve të Avatit nuk paraqitet, në mënyrë të qartë të ndryshme, më arkaike se gjuha e teksteve të De Radës. Nga ana tjetër, ajo nuk paraqit ndonjë ndikim italian më të madh. Këto konstatime shpjegojnë përforcën konservuese të gjuhës në rrethanat e veçanta të izolimit të saj larg truallit amtar e midis një ambienti të huaj shumë më të fortë e të fortë, që i kërcënohet.

Krahasimi i teksteve të Avatit me vjershat e Varibobës duket të vërtetojë jo se shqipja ishte invaduar në të tillë mënyrë nga fjalori italian në librin, siç e gjejmë në krijimet e Varibobës, po se ky pësoi një ndikim të fortë italian, që është i ngjajshëm me atë që pësuan bejtëxhinjtë e Shqipërisë nga gjuhët orientale e sidomos nga turqishtja. Ai ndikim ishte i fortë, i kërkuar me dashje. Të dy palët kishin nënçmimin ose përçmimin e shqipes, që atyre u dukej e varfër dhe e pazonja për vepra të reja, të dy palët i qëndronin përgjithësisht larg traditës popullore letrare. Atyre u dukej se e «fisnikëronin» gjuhën që shkruanin, duke e përçmuar me një mori fjalësh, të cilat i merrnin sidomos prej fjalorit poetik të gjuhëve që njihnin.

E kundërta ngjet tek Avati. Ky i përket rrymës së qëndrës ndaj asimilimit, që lidhet me traditat e lashta popullore. De Rada, duke e mbështetur krijimtartinë e tij në poezinë e popullit, çilte më pas një rrugë të re letrësinë arbëreshe, në kundërshtim me letërsinë përgjithësisht fetare të shek. XVIII. Sikundër e kemi vënë në dukje edhe gjetiu²², ai bëri që letërsia arbëreshe, duke u lidhur ngushtë me lëvizjen kombëtare të Shqipërisë dhe duke hyrë në fazën e saj romantike, jo vetëm u ngrit në rangun e një letërsie me vetija të shquara artistike, por u shkëput edhe nga një farë epigonizmi ndaj letërsisë italiane, që e karakterizonte në shek. XVIII.



Figurë gati e panjohur e folkloristikës shqiptare, në fazën e ngritjes së përpjekjes kulturele dhe letrare arbëreshe, që nis aty nga fundi i shek. XVII dhe mer hov në shek. XVIII, Françesk Avati (1717-1800) ishte një nga të diturit arbëreshë të kohës dhe një nga eksponentët e qëndresës arbëreshe kundër nënshtrimit feudal italian dhe kundër asimilimit. Ai u bë një prekursor me punën për mbledhjen e këngëve popullore shqipe të Kalabrisë, ku lindi dhe e kaloi pjesën e parë të jetës. Mblodhi nja 15 këngë prej të cilave njohim vetëm 3 këngë legjendare dhe një pjesë të atyre të dasmës, kurse për 3 të tjera kemi titullin. Këtë përpjekje ai e bëri në suazën e përpjekjes arbëreshe të kohës për të njohur e për të ruajtur trashëgimin e lashtë të kulturës së tyre, i frymëzuar nga ndjenjat patriotike të admirimit për atë trashëgim dhe të admirimit për popullin e vet, i cili kishte mundur t'i bënte ballë rrebeshit turk dhe po i bënte ballë egërsisë feudale italiane. Këto ndjenja ishin lidhur ngushtë me përpjekjen e arbëreshëve për zhvillimin e kulturës së tyre amtare dhe për afirmimin e kombësisë së tyre në Itali. Ato do të çonin drejt e te lëvizja e madhe që filloi në shek. XIX, kur De Rada me shokë e lidhën përpjekjen e tyre të shquar kulturele, dhe jo vetëm kulturele, por edhe politike, me çështjen e madhe të çlirimit të atdheut të stërgjyshërve, me lëvizjen kombëtare të Shqipërisë.

De Rada kishte dëgjuar me kohë për Avatin, duke trashëguar ndofta prej tij e prej pasardhësve të tij edhe alfabetin me të cilin e shkroi shqipen që më 1833, kur ai hyri kësaj pune. Prej Kamardës, poeti njohu edhe dorëshkrimin e këngëve popullore që Avati u kishte dërguar arbëreshëve të Sicilisë, si një simbol të kombësisë së tyre e të përpjekjes së përbashkët për ta ruajtur kombësinë e për ta zhvilluar kulturën amtare. De Rada e shfrytëzoi lëndën folklorike që njohu prej Avatit, duke e çmuar vlerën e saj, sepse kishte qenë mbledhur para një shekulli, në një kohë kur folklori arbëresh ruhej edhe më mirë se në kohën e tij.

Njohja e Avatit dhe e veprimtarisë së tij ndihmon për të njohur më mirë kapërcimin nga shek. XVIII në shek. XIX arbëresh, që u bë pjesë Rilindjes sonë kombëtare. Kjo vlen të bëhet edhe për figura të tjera të kohës.

R é s u m é

FRANÇESK AVATI

Une figure quasiment inconnue de la folkloristique albanaise dans la phase d'ascension de l'activité culturelle et littéraire des Albanais d'Italie — activité qui s'amorce à la fin du XVII^e siècle pour connaître son essor au XVIII^e — est celle de Françesk Avati (1717-1800). Il était une des personnalités les plus instruites de ce temps et un des représentants les plus en vue de la résistance des Albanais d'Italie contre la sujétion féodale italienne et contre l'assimilation.

Avati fut un des précurseurs à recueillir les chants populaires albanais de la Calabre, d'où il était originaire et où il avait passé la première partie de sa vie. Il recueillit environ 15 chants, dont nous connaissons trois chants légendaires et une partie des chants nuptiaux, cependant que trois autres nous ne les connaissons que de titre. Il fit ces tentatives dans le cadre de tout l'effort des colonies albanaises en Italie à ces temps-là, pour connaître et sauvegarder l'ancien patrimoine de leur culture.

Avati s'inspire aux sentiments patriotiques d'enthousiasme qu'il a pour ce patrimoine et d'admiration pour son propre peuple, lequel avait pu tenir tête à l'avalanche turque de jadis, et qui maintenant faisait face à la férocité féodale italienne. Ces sentiments étaient en rapports étroits avec l'effort des Albanais d'Italie pour développer leur culture nationale et affirmer leur nationalité en Italie même.

Toutes ces tentatives devaient aboutir au grand mouvement qui s'annonça au XIX^e siècle, alors que de Rada et d'autres personnalités des Albanais d'Italie mirent leur mouvement culturel et politique en rapports avec la grande cause de la libération du pays des ancêtres, avec le mouvement national en Albanie même.

De Rada avait entendu longtemps avant parler sur l'Avati. Il avait, selon toute vraisemblance, hérité de lui et de ses prédécesseurs aussi l'alphabet par lequel il écrivit l'albanais dès l'année 1833, quand il fit ses débuts. C'est de Camarda que de Rada connut aussi le manuscrit des chants populaires qu'Avati avait envoyé aux Albanais des colonies de la Sicile, comme un gage de leur nationalité et de l'effort commun à sauvegarder la nationalité et faire développer la culture nationale. De Rada fit un trésor de la matière folklorique connue de l'Avati, en reconnaissant sa valeur, tenant compte du fait qu'elle avait été recueillie un siècle avant, à un temps où le folklore albanais en Italie était mieux conservé que du temps de notre poète.

Connaître l'Avati et son activité signifie mieux connaître le passage du XVIII^e au XIX^e siècle des Albanais d'Italie, dont le patrimoine culturel devint partie de notre Renaissance nationale. Et cet effort de connaissance doit être porté aussi sur d'autres figures de ces temps.

